

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit B.M., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PPI.nr 1014/2013 dt. 31.10.4 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 18.09.2018, në të cilën ish-in të pranishëm prokurori i shtetit – Ilaz Beqiri, si dhe i pandehuri B.M., gjykata me dt. 18.09.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### AKTGJYKIM

**I pandehuri: B.M.**, i biri i R., dhe L., e gjinisë N., i lindur me dt. ..., në fshatin K., KK P., me vendbanim në rr “T.Sh.” nr. ..., Komuna P., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i ... fëmijëve, me profesion sh., me punë të përkohshme në Gj., i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ... i lëshuar nga MPB – RKS, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

**Sepse:** Me datën 13.10.2013 rreth orës 11:52, në Aeroportin Ndërkombëtar Adem Jashari në Prishtinë gjatë kontrollit X – Ray në çek-in, në bagazhin e të pandehurit B.M. është gjetur dhe konfiskuar një elektrohok pa numër serik i tipit 1101 police, me kapacitet 50000ë, prodhim Gjerman i njëjti ka mbajtur në pronësi në kontroll dhe kundërshtim me ligjin.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet 7,17,21,41,43,46,73 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK –së, e gjykon:

### DËNIM ME GJOBË

**Të pandehurit B.M.**, i caktohet dënim me gjobë në lartësi prej **300 € (treqind) euro**, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do të zëvendësoj dënim në gjobë në dënim me burgim, ashtu që një ditë burgimi do t'i llogaritet me 20 € gjobë.

Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedure penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 30 euro, në afatin prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komfor nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPRK-së konfiskohet: elektrohok pa numër serik i tipit 1101 police, me kapacitet 50000 ë, prodhim Gjerman.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë PPI nr 1014/2013 dt. 31.10.2014, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin B.M., për shkak të veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Me datë 18.09.2018, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë çështje penale në të cilën ishin të pranishëm prokurori i shtetit Ilaz Beqiri dhe i pandehuri B.M.. Prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën PPI nr 1014/2013 dt. 31.10.2014, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykes pasiqi u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 245 par.4 të KPPRK-së të njëjtit i dha mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri B.M. në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihej në barrë, duke shtuar, citat *“se është bërë fjalë për një elektrohok të cilët janë të lejuar në shtetin e Gj., lus gjykatën që me rastin e caktimit të llojit të dënimit të merr parasysht tipin e llojit të armës, rrezikshmërinë që mund të sjell ajo, pra behet fjalë për një elektrohok”*

Prokurori i shtetit Ilaz Beqiri pas deklarimit të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar, se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vlerësuar se i njëjti ka kuptuar benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë është bërë në përputhshmëri me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në fund i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merr si rrethane lehtësuese.

Megjithatë i pandehuri e ka pranuar fajësinë, gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza siç janë: vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të sendeve i dt 13.10.2013, procesverbal i dëshmisë – pronës i dt 13.10.2013, si dhe foto albumi që gjendet në shkresat e lëndës nr i rastit 2013-YA-0217 i dt 20.10.2013 dhe shkresat e lëndës, akuza e prokurorisë nuk ka shkelje të qarta ligjore apo gabime faktike, andaj gjykata ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë për të pandehurin B.M. për veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysht të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga i pandehuri, andaj bazuar në nenin 75 par.1 nënpar.1.3 ka zbutur dënimin brenda kufijve për zbutje të dënimit të paraparë me dispozitën e nenit 76 të KPRK-së. Pastaj gjykata si rrethanë tjetër lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, faktin se nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i dënuar për veprë penale, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysht shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si

dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, por edhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit, dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komfor nenit 69 të KPRK-së dhe 115 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**PKR. nr. 593/14, datë 18.09.2018**

**Sekretarja Juridike:**  
**Shqipe Rexhepi**

**Gjyqtari:**  
**Arben Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.